

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHITJA LEKA KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 60569/09)

VENDIM

Neni 6 § 1 (penal) dhe neni 6 § 3 (a), (b) dhe (c) • Seancë dëgjimore e drejtë • Informacion mbi natyrën dhe shkakun e akuzës • Ndihmë juridike falas • Mënyra e kryerjes së paraqitjes për njohje pa shkelur kërkesat për gjykim të drejtë • Ricilësim nga Gjykata e Apelit i akuzave për të cilat u dënua kërkuesi i bazuar në të njëjtat fakte dhe i tillë që mund të ishte parashikuar • Kërkuesi kishte kohë dhe mundësi që të përgatiste mbrojtjen • Nuk ka arsye bindëse për kufizimin e të drejtës së kërkuesit për avokat në fazën e hetimit gjatë pyetjes nga prokuroria • Kontroll shumë i rreptë • Në rrethana specifike të çështjes, drejtësia në përgjithësi e procesit penal nuk cenohet në mënyrë të parikuperueshme nga mungesa e avokatit mbrojtës në atë fazë

Përgatitur nga Zyra e Kancelarit. Nuk është i detyrueshëm për Gjykatën.

STRASBURG
5 mars 2024

Ky vendim do të bëhet përfundimtar në rrethanat e përcaktuara në nenin 44, paragrafi 2 i Konventës. Mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Leka kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *President,*

Jolien Schukking,

Yonko Grozev,

Darian Pavli,

Peeter Roosma,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarët,*

dhe Milan Blaško, *kancelar seksioni,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 60569/09) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") nga një shtetas shqiptar, z. Durim Leka ("kërkuesi"), më 9 nëntor 2009;

vendimin për t'i njoftuar Qeverisë Shqiptare ("Qeveria") ankesat në lidhje me ndryshimin e akuzave kundër kërkuesit nga Gjykata e Apelit, të drejtën e kërkuesit për avokat në fazën e hetimit në procesin penal kundër tij dhe mënyrën se si është kryer paraqitja për njohje dhe për të shpallur të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesës;

parashtrimet e depozituara nga Qeveria dhe prapësimet e paraqitura nga kërkuesi;

komentet e palës së tretë, Res Publica, të cilës i është lejuar nga Kryetari i Seksionit të ndërhyjë në procedurën me shkrim (neni 36 § 2 i Konventës dhe rregulli 44 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 13 shkurt 2024,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në atë datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me padrejtësinë e pretenduar të procesit penal kundër kërkuesit ku ai u dënua për vjedhje me pasojë vdekjen, vrasje të mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje dhe u dënua me burgim të përjetshëm.

FAKTET

2. Kërkuesi ka lindur në vitin 1983 dhe po vuan dënimin me burgim të përjetshëm në një burg të sigurisë së lartë në Shqipëri. Kërkuesi u përfaqësua nga z. S. Puto, avokat i licencuar në Tiranë.

3. Fillimisht qeveria përfaqësohej nga Agjentja e saj në atë kohë znj. A. Hicka dhe më pas nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbliidhen si më poshtë.

I. HETIMI

5. Në kohën kur ka ndodhur ngjarja në fjalë kërkuesi ishte 22 vjeç dhe punonte si murator. Më 23 gusht 2005, A. S. u qëllua për vdekje në Shijan të Sarandës. Vëllai i tij P. S. i cili ishte prezent dhe ndaj të cilit u qëllua gjithashtu, por nuk u godit, shkoi menjëherë në polici dhe denoncoi krimin. Po atë ditë policia bëri këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe gjeti dy gëzhoja në tokë. Gjatë kontrollit që u krye të nesërmen, policia gjeti një tjetër gëzhojë.

6. Më 23 dhe 24 gusht 2005, policia mori në pyetje kërkuesin për të vendosur marrëdhënien e tij me A. S. sepse te ky i fundit ishte gjetur një shënim me numrin e telefonit të kërkuesit. Në kohën kur u bë marrja në pyetje kërkuesi nuk ishte ende i dyshuar dhe ai nuk bëri asnjë deklaram që e inkriminonte gjatë pyetjes. Ai u pyet vetëm nëse e njihte A. S. dhe P. S. dhe u përgjigj se nuk i njihte.

7. Më 24 gusht 2005, prokuroria, si masë urgjente përgjimi të fshehtë, vendosi një aparat dëgjimi në dhomën e pritjes të policisë së Sarandës dhe siguroi një regjistrim të bisedës mes kërkuesit dhe vëllait të tij N. L. që zbuloi se kërkuesi i kishte thënë se ai e kishte vrarë A. S. dhe më pas kishte shkuar në Sarandë, ku kishte dalë në det me një gomone dhe e kishte hedhur armën në drejtim të hotel Grandit në Sarandë.

Prokuroria më pas i kërkoi Gjykatës së Rrethit Sarandë vleftësimin e masës së përgjimit të fshehtë dhe kjo u miratua më 28 gusht 2005.

8. Policia e arrestoi kërkuesin më 27 gusht 2005 dhe ai u mor në pyetje nga prokurorët po atë ditë. Para marrjes në pyetje ai u njoh me të drejtat e tij sipas Kodit të Procedurës Penale, ku përfshihej e drejta për të heshtur dhe për t'u ndihmuar nga një avokat.

Kërkuesi tha se do të bënte deklaramin pa avokat dhe do të vendoste më vonë nëse do të kishte avokat. Ai nënshkroi procesverbalin e marrjes në pyetje, ku thuhej se kërkuesi ishte informuar për të drejtat e tij sipas nenit 309 të Kodit të Procedurës Penale (shih paragrafin 31 më poshtë) dhe se ai nuk kishte bërë asnjë koment.

Kërkuesi pranoi që kishte vrarë A. S. dhe kishte qëlluar ndaj P. S. Ai tha se i duheshin para për dasmën e motrës së tij, të cilat nuk i kishte. Më 23 gusht 2003, rreth mesditës, ai kishte takuar A. S., një tregtar i këmbimit valutor, në Sarandë dhe i kishte kërkuar të këmbente 8000 euro (EUR) për lekë shqiptare (ALL), edhe pse ai nuk i kishte ato para dhe në fakt synimi i tij ishte t'i merrte lekët nga A. S. pa i dhënë asnjë euro në këmbim. Ishte rënë dakord që A. S. të çonte lekët në fshatin Shijan, ku banonte kërkuesi. Rreth orës 17.30. kërkuesi kishte telefonuar A. S. dhe i kishte thënë ta takonte në Shijan në anë të një rruge. Kërkuesi kishte marrë me vete një armë që kishte në shtëpi me qëllim që të trembte A. S. dhe t'i merrte paratë. A. S. kishte mbërritur me motor me vëllanë e tij P. S. Kërkuesi u kishte thënë se nuk i kishte paratë me vete, por ata duhej të shkonin në shtëpinë e tij. Ai i kishte çuar në një shtëpi të braktisur dhe, kur kishin mbërritur atje, kërkuesi kishte nxjerrë armën dhe i kishte kërkuar paratë A. S.-së. A. S. po shkonte drejt kërkuesit kur kërkuesi nxori armën dhe qëlloi A. S., i cili ra në tokë. P. S. filloi të vraponte dhe kërkuesi qëlloi dy herë në drejtim të tij, por nuk e kapi. Menjëherë vëllai i kërkuesit D. L., i cili kishte dëgjuar të shtënat, mbërriti në vendngjarje ku gjeti A. S. të shtrirë

në tokë, të gjakosur dhe që kërkonte ndihmë. Ambulanca mbërriti shpejt, por A. S. vdiq rrugës për në spital.

9. Po atë ditë, në orën 18, u zhvillua një paraqitje për njohje ku, përveç kërkuesit, ishin paraqitur edhe dy persona të tjerë. Kërkuesi kishte veshur një këmishë të errët me mëngë të gjata, ndërsa dy personat e tjerë të paraqitur për njohje mbanin veshur këmisha të bardha me mëngë të shkurtra. P. S., si dëshmitar, u ftua fillimisht të përshkruante personin që kishte qëlluar vëllanë e tij. Në fillim ai bëri një përshkrim të hollësishëm të personit, 1,70 m i gjatë, i hollë, me fytyrë të gjatë, kuqalash me quka në faqe, vetulla kafe në të verdhë, flokë bionde të errët, zë të hollë, të folur të pastër, pa asnjë dialekt.

Gjatë paraqitjes për njohje, pjesëmarrësve iu kërkua të ndërronin vendet tri herë. Çdo herë, P. S. identifikoi kërkuesin si autorin e krimit.

Kërkuesi nënshkroi procesverbalin e paraqitjes për njohje pa bërë asnjë koment.

10. Akt ekspertimi i datës 30 gusht 2005 i hartuar nga Laboratori Qendror i Hetimeve Penale konkludoi se dy gëzhojat kishin dalë nga një armë zjarri, përkatësisht një pistoletë T. T model 54. Arma nuk u gjet asnjëherë.

11. Kërkuesi u pyet përsëri nga prokurori më 14 dhe 22 shtator 2005.

Në procesverbalin e marrjes në pyetje thuhet se kërkuesi u informua për të drejtën e tij për t'u ndihmuar nga një avokat Ai deklaroi se ishte vënë në dijeni të akuzave dhe se do të bënte deklarinimin pa avokat dhe se do të vendoste më vonë nëse do të kishte avokat. Ai nënshkroi procesverbalin pa asnjë koment.

Më 14 shtator 2005 kërkuesi shpjegoi se kishte marrë një varkë me pedale nga Saranda në det dhe kishte hedhur armën në det në drejtim të hotelit Grand në Sarandë.

II. AKTAKUZA

12. Më 4 tetor 2005, avokati S. M., u caktua nga shteti për të përfaqësuar kërkuesin me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte mjete për të paguar për ndihmën juridike të zgjedhur prej tij.

13. Në aktakuzën e datës 5 tetor 2005, e cila iu dorëzua kërkuesit dhe avokatit të tij të njëjtën ditë, kërkuesi u akuzua për vrasjen e A. S. dhe P. S. në rrethana të tjera cilësuese sipas nenit 79(dh) të Kodit Penal, si dhe për mbajtje pa leje të armëve të zjarrit dhe municionit sipas nenit 278 § 2 të Kodit Penal.

14. Më 12 tetor 2005 prokuroria paraqiti një kërkesë që çështja të dërgohej për gjykim me akuzat e vrasjes së A. S. dhe P. S. në rrethana të tjera cilësuese dhe mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit dhe municionit, në bazë të fakteve të mëposhtme. Më 23 gusht 2005, në Shijan, kërkuesi vrau me armë zjarri A. S. dhe në të njëjtën kohë tentoi të vrasë vëllanë e tij, P. S. Para kësaj, kërkuesi dhe A. S. kishte rënë dakord që A. S., i cili ishte tregtar i këmbimit valutor, t'i çonte kërkuesit 2 000 000 lekë nga Saranda në Shijan në këmbim të 8 000 eurove. A. S. mori me vete vëllanë e tij P. S. dhe mbërritën në Shijan me motor. P. S. kishte me vete paratë, disa prej të cilave i kishin marrë nga V. K., një tjetër tregtar i këmbimit valutor në Sarandë. Vëllezërit e takuan kërkuesin në anë të një rruge dhe së bashku shkuan te një vresht aty pranë. Kur arritën, kërkuesi nxori armën dhe qëlloi një herë ndaj A. S. A. S. ra në tokë. Gjithashtu kërkuesi qëlloi dy herë në drejtim të P. S., i cili arriti të largohej me vrap. Ai ndaloi një mjet që po kalonte aty dhe shkoë në policinë e Delvinës. A. S. u dërgua në Spitalin Civil të Sarandës, ku ndërroi jetë.

Gjithashtu u pretendua se kërkuesi kishte kontaktuar A. S. në Sarandë ditën e vrasjes dhe i kishte kërkuar të këmbente 8000 euro me lekë shqiptare, edhe pse kërkuesi nuk e kishte atë shumë parash. Kërkuesi i kishte kërkuar A. S. t'ia çonte në Shijan shumë përkatëse në lek, me pretendimin se kishte frikë të mbante me vete në Sarandë një shumë të madhe eurosh.

III. GJYKIMI NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË

15. Gjatë procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, kërkuesi u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga shteti dhe bëri deklarinimin e tij. Kërkuesi deklaroi se më 23 gusht 2003 ishte takuar me A. S., i cili i kishte borxh 300,000 lekë. A. S. kishte mbërritur në takim i armatosur dhe e kishte kërcënuar

kërkuesin dhe mes tyre kishte nisur një sherr. Kërkuesi i mori armën A. S. dhe e qëllloi. Kërkuesi gjithashtu deklaroi se ai nuk e kishte qëlluar vëllanë e A. S.-së, P. S.

16. P. S. gjithashtu bëri deklarinimin dhe përshkroi ngjarjet në fjalë në të njëjtën mënyrë si kërkuesi në deklarinimet e tij të dhëna në prokurori (shih paragrafin 8 më lart) P. S. tha se A. S. nuk kishte mjaftueshëm lek për të plotësuar kërkesën e kërkuesit. Ai i kishte kërkuar ndihmë V. K. dhe ky i fundit i kishte dhënë 700 000 lek. P. S. tha gjithashtu se ai vetë i kishte mbajtur ato para, të cilat do të shkëmbeheshin për euro me kërkuesin. Pasi kërkuesi e qëllloi vëllanë e tij, P. S. vrapoi drejt policisë dhe e denoncoi.

17. V. K. gjithashtu dha dëshminë e tij dhe konfirmoi se i kishte dhënë A. S. shumën prej 700 000 lekësh për ta shkëmbyer me euro me kërkuesin.

18. D. L., vëllai i kërkuesit, gjithashtu dëshmoi dhe tha se kishte dëgjuar tre ose katër të shtëna dhe se kur kishte mbërritur në vendngjarje kishte gjetur një person të shtrirë në tokë, të gjakosur dhe që po kërkonte ndihmë.

19. Në një vendim të datës 9 dhjetor 2005, Gjykata e Rrethit Sarandë e shpalli kërkuesin fajtor sipas akuzës (për vrasjen e dy ose më shumë personave në rrethana të tjera cilësuese dhe tentativën për vrasje të një personi sipas nenit 79 (dh) dhe 22 të Kodit Penal dhe për armëmbajtje pa leje sipas nenit 278 paragrafi 2 të Kodit Penal) dhe e dënoi me burgim të përjetshëm.

Vendimi mori parasysh raportet e këqyrjeve të vendit të ngjarjes, raportet e autopsisë, akt ekspertimin balistik, paraqitjen për njohje dhe fotografitë, të dhënat e gjetura në telefonin celular të kërkuesit (shih paragrafin 6 më lart), deklarinimet e bëra nga P. S., D. L dhe V. K., zbardhjen e regjistrimit të bisedës mes kërkuesit dhe vëllait të tij N. L. (shih paragrafin 7 më lart), dhe rrëfimin e kërkuesit para prokurorit.

20. Për sa i përket rrëfimit të kërkuesit gjatë hetimit, gjykata u shpreh si më poshtë:

“Gjatë hetimeve i pandehuri pranoi akuzat [e ngritura ndaj tij] duke përshkruar rrethanat [përkatëse]. Megjithatë, në gjyq ai ndryshoi versionin e tij të ngjarjes dhe pretendoi se viktimat i kishin borxh 300 000 lekë të vjetra. I pandehuri deklaroi se kishte qenë viktimë [A. S.] që kishte ardhur i armatosur dhe e kishte kërcënuar [me armë] dhe se pas kësaj ai, i pandehuri, kishte marrë armën e viktimës dhe e kishte qëlluar. Dëshmia e të pandehurit [e dhënë në gjykim] nuk mund të pranohet, sepse deklarinimi i të pandehurit për prokurorinë mbështetet nga [regjistrimi] i përgjuar dhe dëshmia e dëshmitarit P. S., i cili përshkroi ngjarjet [në fjalë] dhe [përshkrimi i të cilit] përputhet plotësisht me deklarinimin e të pandehurit [të bërë në prokurori].”

21. Dënimi i kërkuesit iu referua fakteve të përshkruara në kërkesën e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq (shih paragrafin 14 më lart). Gjithashtu deklarohet se gjatë takimit të tij të parë me A. S., mëngjesin e datës 23 gusht 2005, në Sarandë, kërkuesi kishte krijuar tashmë synimin për t'i marrë paratë prej tij dhe se me këtë synim kërkuesi i kishte kërkuar A. S. që të këmbente shumën prej 8 000 eurosh me monedhën shqiptare dhe i kishte kërkuar që atë pasdite t'i çonte në Shijan shumën përkatëse të lekëve.

IV. PROCESI NË APEL

22. Më 17 dhjetor 2005, kërkuesi depozitoi një ankim kundër vendimit të shkallës së parë. Në ankim ai shprehet se avokati i tij kishte refuzuar ta ndihmonte dhe se ai po e paraqiste ankimin vetë në mënyrë që të respektonte afatin kohor për paraqitjen e tij. Më pas, kërkuesit iu caktua një avokat tjetër, i cili mori pjesë në seanca dhe paraqiti çështjen e kërkuesit. Ai paraqiti ankimin në një seancë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë. Ai argumentoi, *inter alia*, se ishte shkelur e drejta e kërkuesit për t'u marrë në pyetje në prani të një avokati të zgjedhur prej tij ose të caktuar për të në fazën paraprake të procesit dhe se kërkuesi kishte nënshkruar procesverbalin e marrjes në pyetje nga prokuroria me detyrim.

23. Në një seancë të mbajtur para Gjykatës së Apelit më 16 mars 2006, avokati i kërkuesit deklaroi se kërkuesi nuk kishte kryer veprat për të cilat ishte dënuar nga gjykata e shkallës së parë, por se ai

mund të kishte kryer një vepër tjetër. Në seancën e mbajtur më 5 prill 2006, ai kërkoi ndryshimin e akuzës ndaj kërkuesit nga vepra penale sipas nenit 79 (dh) në veprën e parashikuar në nenin 76 të Kodit Penal.

24. Më 5 prill 2006, Gjykata e Apelit Gjirokastrë e shpalli kërkuesin fajtor për vjedhje e mbetur në tentativë me pasojë vdekjen, ku A. S. ishte viktimë, sipas neneve 141 dhe 22 të Kodit Penal, si edhe për vrasje të mbetur në tentativë të P. S. me synimin për të kryer një krim tjetër, sipas neneve 77 dhe 22 të Kodit Penal, si edhe për armëmbajtje pa leje sipas nenit 278 § 2 të Kodit Penal, dhe e la në fuqi dënimin e tij.

25. Vendimi mbështetej në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, të dhënat nga celulari i kërkuesit si provë materiale, raportin mjekësor për shkakun e vdekjes së A. S., akt ekspertimin balistik për armën dhe gëzhojat e gjetura, rezultatet e përgjimit të fshehtë, dhe deklaratimet e dëshmitarëve P. S., D. L. dhe V. K.

Vendimi nuk përmendte fare paraqitjen për njohje, apo rrëfimin e kërkuesit në prokurori.

26. Gjykata e Apelit u shpreh se gjykata e shkallës së parë kishte zbatuar gabim ligjin për faktet e provuara kur gjeti se kërkuesi kishte vrarë A. S. dhe se për rrjedhojë sipas nenit 428(b) të Kodit të Procedurës Penale, cilësimi ligjor i veprës penale duhej të ndryshonte në vjedhje e mbetur në tentativë me pasojë vdekjen e A. S. (nenet 141 dhe 22 të K. Penal), dhe vrasje e mbetur në tentativë të P. S. (Nenet 22 dhe 77 të Kodit Penal). Gjykata e Apelit shpjegoi se motivi i kërkuesit kishte qenë të vidhte nga A. S. lekët që ai kishte me vete dhe se për këtë qëllim kërkuesi kishte mashtruar A. S. që në fillim, duke e bërë atë të besonte në mënyrë të rreme se kërkuesi kishte 8,000 euro për të këmbyer, ndërkohë që kërkuesi nuk e kishte atë shumë parash. Kështu, qëllimi kryesor i kërkuesit ishte t'i merrte paratë A. S., qëllim të cilin ai nuk e realizoi sepse paratë i kishte P. S. dhe ai ia doli të shpëtonte. Për sa i përket P. S., Gjykata e Apelit u shpreh se i pandehuri nuk e kishte parashikuar që A. S. do të shoqërohej nga vëllai i tij dhe se i pandehuri kishte qëlluar dy herë në drejtëm të P. S. me qëllim për ta vrarë, por nuk ia kishte dalë.

Sa i përket akuzës për armëmbajtje pa leje, Gjykata e Apelit ka pranuar cilësimin e gjykatës së shkallës së parë.

V. PROCESE TË MËTEJSHME

27. Ankimi vijues i kërkuesit në Gjykatën e Lartë u rrëzua përfundimisht.

28. Më pas, kërkuesi paraqiti një ankim kushtetues, i cili u rrëzua më 19 maj 2009. Sa i përket ricilësimit të akuzave, pjesa përkatëse e vendimit të Gjykatës Kushtetuese lexon:

“Në rastin në shqyrtim, gjykata e apelit ka bërë ndryshimin e cilësimit juridik të fakteve pa i ndryshuar [faktet] dhe ka sqaruar kuptimin e ligjit që duhet të zbatohet për të siguruar njëkohësisht stabilitetin [zbatimin] e së drejtës. Në këtë drejtëm, edhe neni 425/3 i Kodit të Procedurës Penale ka pranuar se kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata e apelit nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, por nuk ka ndalim që [gjykata e apelit] t'i japë faktit një cilësim juridik të ndryshëm ose më të rëndë nga ai që i ka dhënë gjykata e rrethit.”.

LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

I. KUSHTETUTA

29. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës shqiptare, në fuqi në kohën e ngjarjes, lexojnë si më poshtë:

Neni 31

“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

- a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;
- b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;
- ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

...”.

II. KODI PENAL

30. Dispozitat përkatëse të Kodit Penal në fuqi në kohën e ngjarjes, lexojnë si më poshtë:

Neni 22

Kuptimi i tentativës

“Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.”.

Neni 76

Vrasja me dashje

“Vrasja e kryer me dashje dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”.

Neni 77

Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër

“Vrasja me dashje, që paraprin, shoqëron, fsheh ose pason një krim tjetër, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet”.

Neni 79

Vrasja në rrethana të tjera cilësuese

Vrasja me dashje e kryer:

...

d) më shumë se një herë;

dh) kundër dy ose më shumë personave;

...dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.”.

Neni 141

Vjedhja me pasojë vdekjen

“Vjedhja që ka sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.”.

Neni 278

Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit

“... ”

2. Mbajtja e armëve, bombave, minave ose materialeve shpërthyese pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.”.

III. KODI I PROCEDURËS PENALE

A. Kodi i Procedurës Penale

31. Dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale në fuqi në kohën e ngjarjes, lexojnë si më poshtë:

Neni 49 §§ 1 dhe 2

“1. I pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të, ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga organi që procedon, në qoftë se e kërkon atë.

2. Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme.”

Neni 158 § 1

“1. Nuk janë të detyruar të dëshmojnë:

a) gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit,”.

Neni 296/1 i Kodit të Procedurës Penale e bën të detyrueshme praninë e avokatit gjatë pyetjes nga policia gjyqësore së personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet. Në të njëjtën dispozitë, nëse nuk gjendet

avokat ose avokati nuk merr pjesë në një seancë, prokurorit i kërkohet të caktojë një avokat kryesisht për të dyshuarin.

Neni 309

“1. I pandehuri që nuk ka mbrojtës njoftohet nga prokurori se ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar kryesisht nga autoritetet [përkatëse].

2. Mbrojtësi i zgjedhur [nga avokati] ose i caktuar kryesisht nga autoritetet [përkatëse] lajmërohet të paktën njëzet e katër orë përpara kur procedohet me marrje në pyetje [të të pandehurit], dhe për këqyrje ose ballafaqim. Kur vonesa mund të ketë pasoja negative për procesin, lajmërimi i mbrojtësit bëhet urgjentisht.

3. Procesverbalet e veprimeve të kryera nga prokurori dhe nga policia gjyqësore, në të cilat mbrojtësi ka të drejtë të asistojë, depozitohen në sekretarinë e prokurorisë brenda tri ditëve nga kryerja e veprimit, me të drejtën për mbrojtësin që t'i shqyrtojë dhe të nxjerrë kopje.”.

Neni 425

“...

3. Kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata e apelit nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë për shkaqe më pak të favorshme nga ai i vendimit të apeluar, as të bëjë cilësim ligjor më të rëndë të fakteve.”.

B. Kodi i Procedurës Penale i ndryshuar (që hyri në fuqi më 1 gusht 2017)

32. Neni 34/a/2 i Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar kërkon që përpara marrjes në pyetje për herë të parë, organi procedues t'i japë të dyshuarit letrën e të drejtave që përmban informacion për të drejtën e tij për t'u mbrojtur, të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për avokat të zgjedhur nga vetë i dyshuari ose për ndihmë juridike falas sipas disa kushteve.

Neni 49/1 i Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar, parashikon:

“1. Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur:

“...

ç) është akuzuar për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënim në maksimum jo më pak se 15 vjet me burgim;

“...”.

LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR PËRKATËS

I. KËSHILLI I EVROPËS

33. Rregulli 93 i Rregullave Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve (Rezoluta (73) 5 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës) parashikon:

“Një i burgosur që nuk është gjykuar ka të drejtë, sapo të burgoset, të zgjedhë përfaqësimin e tij ligjor ... dhe të presë vizita nga këshilluesi i tij ligjor me qëllim mbrojtjen e tij dhe të përgatitë dhe t'i dorëzojë atij dhe të marrë udhëzime konfidenciale. Me kërkesën e tij, atij do t'i krijohen të gjitha lehtësitë e nevojshme për këtë qëllim. ... Intervistat ndërmjet të burgosurit dhe këshilluesit të tij ligjor mund të bëhen me mbikëqyrje pamore, por jo me dëgjim, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të një nëpunësi të policisë ose të institucionit.”.

34. Gjithashtu, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare të Këshillit të Evropës mbi Rregulloren Evropiane të Burgjeve (Rec (2006)2), i miratuar më 11 janar 2006 në takimin e 952^{të} Zëvendës Ministrave, për aq sa ka lidhje, lexon si më poshtë:

“Këshillim juridik

23.1 Të gjithë të burgosurit kanë të drejtë për këshillim juridik dhe autoritetet e burgut duhet t'u ofrojnë atyre lehtësi të përshtatshme për të pasur të drejtën për këtë këshillim.

23.2 Të burgosurit mund të konsultohen për çdo çështje ligjore me një këshillues ligjor të zgjedhur prej tyre dhe me shpenzimet e tyre.

“...

23.5 Një autoritet gjyqësor në rrethana të jashtëzakonshme mund të autorizojë kufizime mbi këtë konfidencialitet për të parandaluar krime të rënda ose shkelje të mëdha të sigurisë së burgut.”.

II. ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA

Pakti Ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike (“ICCPR”)

35. Neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike (“Pakti”) 1966 mbron të drejtën për gjykim të drejtë. Pjesët përkatëse të kësaj dispozite lexojnë si më poshtë:

“Neni 14

...

3. Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësisht të barabartë të ketë këto garanci minimale:

...

b) Të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tij;

...

d) Të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje, duhet të informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe, kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t'i caktohet një mbrojtje falas në cilindo rast të tillë nëse ai nuk ka mjete për të paguar;”.

36. Komiteti i të Drejtave të Njeriut (KDNJ) është organi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Paktit me anë të raporteve periodike të shteteve dhe komunikimeve individuale.

37. Pjesa përkatëse e Komentit të Përgjithshëm nr. 31 të KDNJ-së, dok. CCPR/C/GC/32 (2007) lexon si më poshtë:

“Dhënia ose mungesa e ndihmës juridike shpesh përcakton nëse një person mund të marrë pjesë në proceset përkatëse ose të marrë pjesë në to në mënyrë domethënëse. Ndërsa neni 14 trajton në mënyrë të shprehur garancinë e ndihmës juridike në proceset penale në paragrafin 3 (d), Shtetet inkurajohen të ofrojnë ndihmë juridike falas në raste të tjera, për personat që nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar. Në disa raste, ata madje mund të detyrohen ta bëjnë këtë gjë. Për shembull, kur një person i dënuar me vdekje kërkon rishikim kushtetues të parregullsive në një proces penal, por nuk ka mjete të mjaftueshme për të përballuar kostot e ndihmës juridike për të ndjekur një mjet të tillë, shteti është i detyruar të ofrojë ndihmë juridike në përputhje me neni 14, paragrafi 1, në lidhje me të drejtën për një mjet juridik efektiv siç parashikohet në nenin 2, paragrafi 3 të Paktit.”.

38. KDNJ vlerëson se ndihma juridike duhet të jetë e mundur jo vetëm në fazën e gjyqimit, por në të gjitha fazat e procesit (shih *Kelly kundër Xhamajkës*, 1991, 253/1987, § 5.10., dhe *Borisenko kundër Hungarisë*, 2002, 852/1999, § 7.5), sidomos gjatë marrjes në pyetje nga policia (shih *Gridin kundër Federatës Ruse*, 2000, 770/1997, § 8.5). Megjithatë, në *Levinov kundër Bjellorusisë* (2011, 1812/2008, § 8.3), KDNJ-ja u shpreh se në mungesë të një mase hetimore gjatë periudhës kur i dyshuari nuk kishte pasur mundësi për avokat, autoritetet nuk e kishin shkelur nenin 14 § 3 (b) të Paktit.

39. Gjithashtu, në disa çështje, KDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 14 § 3 (d) të Paktit për shkak të mosinformimit të të akuzuarit për të drejtën e tij për ndihmë juridike (shih, për shembull, *Saidova kundër Tashkistanit*, 2004, 964/2001, dhe *Khoroshenko kundër Federatës Ruse*, 2011, 1304/2004).

III. E DREJTA E BASHKIMIT EVROPIAN

A. E drejta për t'u informuar

40. Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 22 majit 2012 mbi të drejtën e informimit në procese penale, OJ 2012 L 142, bazohet në të drejtat e përcaktuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, dhe në veçanti nenet 6, 47 dhe 48 të tij, duke u mbështetur në nenet 5 dhe 6 të Konventës siç janë interpretuar nga kjo Gjykatë. Në preambulën e saj, Direktiva shpjegon se e drejta e informimit për të drejtat procedurale “e cila rezulton nga praktika gjyqësore” e kësaj Gjykate, duhet të përcaktohet shprehimisht nga Direktiva.

41. Neni 1 i Direktivës sqaron se e drejta e informimit ka dy aspekte: informacion mbi të drejtat procedurale dhe informimi mbi akuzën. Sipas nenit 2, Direktiva zbatohet nga momenti që një person vihet në dijeni nga autoritetet kompetente se ai dyshohet ose akuzohet se ka kryer një vepër penale. Këtij personi duhet t'i jepet menjëherë informacion të paktën në lidhje me pesë të drejtat procedurale të renditura në nenin 3, pjesa përkatëse e të cilave është si më poshtë:

“Neni 3

E drejta për t'u informuar për të drejtat

1. Shtetet anëtare sigurojnë që të dyshuarve ose të akuzuarve t'u jepet menjëherë informacion të paktën në lidhje me të drejtat e mëposhtme procedurale, siç zbatohen sipas legjislacionit kombëtar, në mënyrë që të mundësohet zbatimi i këtyre të drejtave në mënyrë efektive:

- a) e drejta për avokat;
- b) e drejta për këshillim juridike falas dhe kushtet për marrjen e këtij këshillimi;
- c) e drejta për t'u informuar për akuzën, në përputhje me nenin 6;
- (...)

2. Shtetet Anëtare sigurojnë që informacioni i parashikuar në paragrafin 1 të jepet gojarisht ose me shkrim, në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke marrë parasysh çdo nevojë të veçantë të të dyshuarve të cënueshëm ose personave të akuzuar të cënueshëm.”.

B. E drejta për avokat

42. Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetorit 2013 mbi të drejtën për avokat në procese penale dhe në proceset e urdhërarrestit evropian, dhe mbi të drejtën për të informuar një palë të tretë për heqjen e lirisë dhe për të komunikuar me persona të tretë dhe me autoritetet konsullore gjatë heqjes së lirisë, OJ 2013 L 294, përcakton rregullat minimale në lidhje me të drejtën për avokat në proceset penale dhe në proceset e ekzekutimit të një urdhërarresti evropian. Në këtë mënyrë, ajo promovon zbatimin e Kartës, sidomos të neneve 4, 6, 7, 47 dhe 48 të saj, duke u mbështetur në nenet 3, 5, 6 dhe 8 të Konventës, siç interpretohen nga kjo Gjykatë. Në Recitalin 21 të saj, ajo shpjegon, duke iu referuar praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, se kur një person i ndryshëm nga i dyshuari ose personi i akuzuar, si për shembull një dëshmitar, bëhet person i dyshuar ose i akuzuar, ai person duhet të mbrohet nga vetë-inkriminimi dhe ka të drejtë të heshtë. Në këto raste, marrja në pyetje nga organet e zbatimit të ligjit duhet të pezullohet menjëherë dhe mund të vazhdojë vetëm nëse personi në fjalë është vënë në dijeni se ai është person i dyshuar ose i akuzuar dhe mund të ushtrojë plotësisht të drejtat e parashikuara në Direktivë.

Dispozitat përkatëse të Direktivës lexojnë si më poshtë:

“Neni 2

Objekti

1. Kjo Direktivë zbatohet për personat e dyshuar ose të akuzuar në një proces penal që nga momenti kur ata janë vënë në dijeni nga autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar, me njoftim zyrtar ose tjetër, se dyshohen ose akuzohen për kryerjen e një vepre penale, dhe pavarësisht nga fakti nëse u është hequr apo jo liria. Ajo zbatohet deri në përfundimin e procesit, që nënkupton vendimin përfundimtar të çështjes nëse i dyshuari apo i akuzuari e ka kryer veprën penale, duke përfshirë, sipas rastit, dënimin dhe vendimin në apel.

2. Kjo Direktivë zbatohet për personat që u nënshtrohen proceseve të urdhërarrestit evropian (personat e kërkuar) që nga momenti i arrestimit të tyre në shtetin anëtar ekzekutues në përputhje me nenin 10.

3. Kjo Direktivë zbatohet gjithashtu, në të njëjtat kushte siç parashikohet në paragrafin 1, për persona të ndryshëm nga personat e dyshuar ose të akuzuar, të cilët, gjatë marrjes në pyetje nga policia ose nga një autoritet tjetër ligjzbatues, bëhen të dyshuar ose të akuzuar.

(...)

Neni 3

E drejta për avokat në proces penal

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që personat e dyshuar dhe të akuzuar të kenë të drejtën për avokat në kohën dhe mënyrën që u mundëson atyre personave ushtrimin e të drejtave të tyre të mbrojtjes në mënyrë praktike dhe efektive.

2. Personat e dyshuar ose të akuzuar duhet të kenë të drejtë për avokat pa vonesa të panevojshme. Në çdo rast, personat e dyshuar ose të akuzuar do të kenë të drejtën për avokat nga cilido nga momentet e mëposhtme kohore që është më i hershëm:

- a) përpara se të merren në pyetje nga policia ose nga një autoritet tjetër ligjzbatues ose gjyqësor;
- b) me t'u kryer nga autoritetet hetimore ose autoritetet e tjera kompetente një veprim hetimor ose një veprim tjetër për mbledhjen e provave në përputhje me paragrafin 3 (c);
- c) pa vonesa të panevojshme pas heqjes së lirisë;
- d) kur ata janë thirrur për t'u paraqitur para një gjykate që ka juridiksion për çështjet penale, në kohën e duhur përpara se të dalin para asaj gjykate.

3. E drejta për avokat përfshin sa vijon:

a) Shtetet Anëtare do të sigurojnë që personat e dyshuar ose të akuzuar të kenë të drejtën të takohen privatisht dhe të komunikojnë me avokatin që i përfaqëson, sidomos para marrjes në pyetje nga policia ose nga një autoritet tjetër ligjzbatues ose gjyqësor;

b) Shtetet Anëtare sigurojnë që personat e dyshuar ose të akuzuar të kenë të drejtën që avokati i tyre të jetë i pranishëm dhe të marrë pjesë në mënyrë efektive gjatë marrjes në pyetje. Kjo pjesëmarrje do të jetë në përputhje me procedurat sipas ligjit kombëtar, me kusht që këto procedura të mos cenojnë ushtrimin efektiv dhe thelbin e së drejtës në fjalë. Kur një avokat merr pjesë gjatë marrjes në pyetje, fakti që kjo pjesëmarrje ka ndodhur duhet të regjistrohet duke përdorur procedurën e regjistrimit në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar në fjalë;

c) Shtetet Anëtare sigurojnë që personat e dyshuar ose të akuzuar të kenë, të paktën, të drejtën që avokati i tyre të marrë pjesë në veprimet e mëposhtme hetimore ose të mbledhjes së provave, ku këto veprime parashikohen nga legjislacioni kombëtar dhe nëse personi i dyshuari ose i akuzuar kërkohet ose lejohet të marrë pjesë në veprimin në fjalë:

- i. paraqitja për njohje;
- ii. ballafaqimi;
- iii. rindërtimi i vendngjarjes.

4. Shtetet Anëtare përpiqen të vënë në dispozicion informacion të përgjithshëm për të lehtësuar marrjen e një avokati nga personat e dyshuar ose të akuzuar.

Pavarësisht nga dispozitat e ligjit kombëtar në lidhje me praninë e detyrueshme të një avokati, Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që personat e dyshuar ose të akuzuar të cilëve u është hequr liria të jenë në gjendje të ushtrojnë efektivisht të drejtën e tyre për avokat, përveç rasteve kur ata kanë hequr dorë nga kjo e drejtë në përputhje me nenin 9.

5. Në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm në fazën para gjykimit, Shtetet Anëtare mund të shmangin përkohësisht zbatimin e paragrafit 2 (c), kur largësia gjeografike e një të dyshuari ose të akuzuari e bën të pamundur sigurimin e së drejtës për avokat pa vonesa të panevojshme pas heqjes së lirisë.

6. Në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm në fazën para gjykimit, Shtetet Anëtare mund të shmangin përkohësisht zbatimin e të drejtave të parashikuara në paragrafin 3 në masën e justifikuar nisur nga rrethanat e veçanta të çështjes, bazuar në një nga arsyet e mëposhtme bindëse:

a) kur ekziston nevoja urgjente për të shmangur pasoja të rënda negative për jetën, lirinë ose integritetin fizik të një personi;

b) kur veprimi i menjëhershëm nga autoritetet hetimore është i detyrueshëm për të parandaluar rrezikun thelbësor ndaj procedimeve penale.

(...)

Neni 9 Heqja dorë

1. Pa cenuar legjislacionin kombëtar që kërkon praninë ose ndihmën e detyrueshme të një avokati, Shtetet Anëtare sigurojnë që, në lidhje me çdo heqje dorë nga e drejta e përmendur në nenet 3 dhe 10:

a) të dyshuarit ose të akuzuarit t'i jetë dhënë, me gojë ose me shkrim, informacion i qartë dhe i mjaftueshëm në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për përmbajtjen e së drejtës në fjalë dhe pasojat e mundshme të heqjes dorë prej saj; dhe

b) heqja dorë të jetë bërë në mënyrë vullnetare dhe pa mëdyshje.

2. Heqja dorë, e cila mund të bëhet me shkrim ose me gojë, do të regjistrohet, ashtu si edhe rrethanat në të cilat është bërë heqja dorë, duke përdorur procedurën e regjistrimit në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar në fjalë.

3. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të dyshuarit ose personat e akuzuar të mund të revokojnë një heqje dorë më pas në çdo moment gjatë procesit penal dhe që ata të jenë të informuar për këtë mundësi. Ky revokim hyn në fuqi që nga momenti që ndodh.

(...)

Neni 11 Ndihma juridike

Kjo Direktivë nuk cenon ligjin kombëtar në lidhje me ndihmën juridike, e cila do të zbatohet në përputhje me Kartën dhe KEDNJ-në.

Neni 12 Mjetet juridike

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që të dyshuarit ose të akuzuarit në procese penale, si edhe personat e kërkuar në proceset e urdhërarrestit evropian, të kenë një mjet juridik efektiv sipas ligjit kombëtar në rast të shkeljes së të drejtave sipas kësaj Direktive.

2. Pa cenuar rregullat dhe sistemet kombëtare për pranueshmërinë e provave, Shtetet Anëtare sigurojnë që, në procese penale, në vlerësimin e deklarimeve të bëra nga të dyshuarit ose të akuzuarit ose të provave të marra në shkelje të së drejtës së tyre për avokat ose në rastet kur derogimi i kësaj të drejte është autorizuar në përputhje me nenin 3(6), të respektohen e drejta për t'u mbrojtur dhe drejtësia e procesit penal.”.

LEGJISLACIONI

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 §§ 1 DHE 3 (a), (b) DHE (c) TË KONVENTËS

43. Kërkuesi u ankua se procesi penal kundër tij kishte qenë i padrejtë për shkak të ricilësimit të veprës nga gjykata e apelit dhe për shkak të kufizimit të së drejtës së tij për të pasur një avokat gjatë fazës së hetimit paraprak dhe përdorimit të mëvonshëm nga gjykata të provave që ai kishte dhënë në mungesë të avokatit për dënimin e tij dhe mënyrën se si ishte kryer paraqitja për njohje. Ai u mbështet në nenin 6 §§ 1 dhe 3 (a), (b) dhe (c) të Konventës, të cilat, për aq sa ka lidhje, lexojnë si më poshtë:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht,ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

...”.

A. Pranueshmëria

1. Respektimi i afatit gjashtë mujor

a) Parashtrimet e palëve

44. Qeveria argumentoi se kërkesa ishte dorëzuar jashtë afatit kohor prej gjashtë muajsh. Në lidhje me këtë, ata pohuan se vendimi përfundimtar i brendshëm, i dhënë nga Gjykata Kushtetuese më 19 maj 2009, i ishte njoftuar kërkuesit më 1 qershor 2009, ndërsa kërkuesi kishte paraqitur kërkesën e tij të plotësuar në Gjykatë më 25 shkurt 2010. Ata u mbështetën në arsyetimin e Gjykatës në çështjen *Kemevauko kundër Holandës* ((vendim), nr. 65938/09, 1 qershor 2010), duke cituar paragrafët e mëposhtëm:

“22. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se në parim duhet t'i jepet kopja origjinale e formularit të kërkesës si edhe e formularit të autorizimit nëse kërkuesi përfaqësohet në proceset e Strasburgut. Dërgimet e këtyre dokumenteve me faks, pa i dorëzuar Gjykatës kopjet origjinale të këtyre dokumenteve, janë të pamjaftueshme për të përbërë një kërkesë të plotë ose të vlefshme. Në lidhje me këtë, i referohemi paragrafëve 1 dhe 4-5 të Udhëzimit të Praktikës për Fillimin e Procesit, të cituar më sipër. Paragrafi i fundit i përmendur lexon në mënyrë specifike se është kërkesa origjinale e firmosur ajo që duhet të dërgohet me postë brenda tetë javëve nga data e shkresës së Kancelarit që i kërkon kërkuesit të plotësojë dhe të kthejë formularin.

23. Prandaj, fakti që formulari i plotësuar i kërkesës në rastin konkret i është dërguar Kancelarit me faks më 4 mars 2010 është i parëndësishëm për sa kohë që formulari origjinal nuk është dërguar gjithashtu brenda periudhës tetë javore, e cila përfundoi më 4 mars 2010. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se edhe pse shkresa përcjellëse e formularit të kërkesës, si edhe vetë formulari, në fakt mbanin datën 4 mars 2010, zarfi që përmbante formularin origjinal të plotësuar të kërkesës, si dhe formularin e autorizimit të nënshkruar dhe kopjet e të gjitha dokumentet përkatëse, është vulosur më 10 mars 2010.

24. Në praktikën e saj gjyqësore lidhur me pyetjen nëse një kërkesë është paraqitur brenda gjashtë muajve nga marrja e vendimit përfundimtar, Gjykata është shprehur se – në një çështje që nuk përfshinte dërgimin me faks – në mënyrë që data e paraqitur në një komunikim të parë të konsiderohet si data e paraqitjes së kërkesës, ajo duhet të postohet të paktën ditën pas datës që jepet në komunikim. Nëse ai komunikim është vulosur më shumë se një ditë më vonë, është data e vullës postare - dhe jo data që mban shkresa ose formulari i kërkesës - ajo që do të konsiderohet si data e paraqitjes (shih *Arslan kundër Turqisë* (vend.), nr. 36747/02, GJEDNJ 2002-X (ekstrakte)). Gjykata nuk sheh asnjë arsye për të zbatuar një kriter tjetër në lidhje me pyetjen nëse formulari origjinal i kërkesës është dorëzuar brenda periudhës tetë javore.”.

45. Kërkuesi parashtrroi se ai kishte dërguar shkresën e tij të parë në Gjykatë nëpërmjet përfaqësuesit të tij më 9 nëntor 2009, duke kërkuar që t'i dërgohej formulari i kërkesës. Gjykata i kishte dërguar atij formularin e kërkesës së bashku me një shkresë të datës 17 nëntor 2009; megjithatë, kjo korrespondencë nuk arriti kurrë te përfaqësuesi i kërkuesit dhe më 13 janar 2010, kërkuesi i kërkoi Gjykatës të ridërgonte formularin e kërkesës dhe të shtynte afatin për dorëzimin e formularit të plotësuar. Më 14 janar 2010, Gjykata e ridërgoi formularin e kërkesës dhe e zgjati afatin për dorëzimin e kërkesës së plotësuar deri më 28 shkurt 2010. Kërkuesi u shpreh se ai e kishte dorëzuar formularin

e plotësuar të kërkesës më 25 shkurt 2010 dhe kështu kishte respektuar afatin kohor prej gjashtë muajve.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Parime të përgjithshme

46. Gjykata vëren që në fillim se shkresa e parë që shprehte synimin për të paraqitur një kërkesë në Gjykatë u dërgua nga kërkuesi më 9 nëntor 2009. Në atë kohë, parimet e mëposhtme ishin vendosur në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

47. Për sa i përket pikënisjes së afatit 6-mujor në atë kohë në fuqi, Gjykata është shprehur vazhdimisht se objekti dhe qëllimi i nenit 35 § 1 të Konventës zbatohen më së miri duke llogaritur periudhën gjashtëmujore që fillon nga data e dërgimit të vendimit përfundimtar me shkrim ose vendimit të miratuar në proceset e brendshme (shih, për shembull, *Worm kundër Austrisë*, 29 gusht 1997, § 33, *Raportet e vendimeve* 1997-V; *Aras kundër Turqisë* (vend.), nr. 29643/05, 2 mars 2010 dhe *Marina kundër Letonisë*, nr. 46040/07, §§ 39–44, 26 tetor 2010).

48. Sa i përket datës së kërkesës, Gjykata ka vendosur se në përputhje me praktikën e konsoliduar të institucioneve të Konventës dhe Rregullin 47 § 5 të Rregullores së Gjykatës, ajo normalisht datën e paraqitjes së një kërkesë konsideron datën e komunikimit të parë që tregon synimin për të paraqitur një kërkesë dhe jep disa të dhëna mbi natyrën e kërkesës (shih *Chalkley kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 63831/00, 26 shtator 2002). Ky komunikim i parë, i cili mund të marrë formën e një shkrese të dërguar me faks, do të ndërpresë vijimin e periudhës gjashtëmujore (shih *Kemevauko*, cituar më sipër, § 19).

ii. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

49. Gjykata vëren se, siç u tha më lart, kërkuesi dërgoi shkresën e parë ku shprehu synimin e tij për të paraqitur një kërkesë në Gjykatë më 9 nëntor 2009. Në atë shkresë kërkuesi shprehu dëshirën për të paraqitur një kërkesë në Gjykatë duke pretenduar shkelje të nenit 6 § 3 të Konventës.

50. Gjykata ia dërgoi formularin e kërkesës përfaqësuesit të kërkuetit me një afat deri më 12 janar 2010 për dorëzimin e formularit të plotësuar të kërkesës. Ky afat u shty nga Gjykata deri më 28 shkurt 2010.

51. Në çështjen e *Kemevauko* (cituar më lart), ku u mbështet Qeveria, Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme sepse ishte paraqitur jashtë afatit gjashtëmujor, për shkak se formulari i kërkesës nuk ishte dërguar brenda afatit të caktuar nga Gjykata për depozitim me postë, por ishte dërguar vetëm me faks.

52. Në këtë çështje, kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, dërgoi formularin e plotësuar të kërkesës me postë të rregullt më 25 shkurt 2010, domethënë brenda afatit të shtyrë të caktuar nga Gjykata. Nga kjo vijon se kërkuesi ka respektuar afatin gjashtëmujor dhe se kundërshtimi i Qeverisë duhet të rrëzohet.

2. Konkluzione mbi pranueshmërinë

53. Gjykata vëren se kërkesa nuk është as haptazi e pabazuar dhe as e papranueshme për ndonjë nga shkaqet e tjera të renditura në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

B. Themeli

1. Paraqitja për njohje

a) Parashtrimet e palëve

54. Kërkuesi pretendoi se paraqitja për njohje ishte kryer pa pasur një avokat mbrojtës dhe se gjatë paraqitjes për njohje ai kishte veshur këmishë me mëngë të gjata me ngjyrë të errët, ndërsa dy pjesëmarrësit e tjerë kishin veshur këmisha të bardha me mëngë të shkurtra, duke e veçuar kështu dhe duke shërbyer si ftesë për ta identifikuar si autor. Ai u mbështet në çështjen *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë* (nr. 12315/04 dhe 17605/04, §§ 63–72, 20 prill 2010), ku Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 §

1 të Konventës sepse kërkuesit kishin veshur kapuçë me ngjyre të ndryshme nga ato që mbanin të gjithë personat e tjerë në paraqitjen për njohje.

55. Qeveria argumentoi se paraqitja për njohje ishte kryer në përputhje me rregullat e procedurës së brendshme. Për sa i përket mbështetjes së kërkuesit të çështja *Laska dhe Lika* (cituar më lart), Qeveria shpjegoi se në atë çështje elementi vendimtar i njohjes kishte qenë ngjyra e maskave që kishin veshur autorët dhe se kërkuesit në atë çështje ishin të vetmit persona në paraqitjen për njohje të veshur me maska të asaj ngjyre specifike. Megjithatë, në çështjen në fjalë, ngjyra e rrobave nuk kishte asnjë rëndësi për sa i përket identifikimit të autorit, sepse personi që iu kërkua të identifikonte autorin në paraqitjen për njohje ishte P. S., dëshmitar okular dhe një nga viktimat që kishte parë qartë fytyrën e kërkuesit.

b) Parashtrimet e palës së tretë

56. Pala e tretë, Res Publica, nuk bëri komente në lidhje me këtë ankesë.

c) Vlerësimi i Gjykatës

57. Për sa i përket mënyrës se si u zhvillua paraqitja për njohje, Gjykata vëren se është e vërtetë që rrobat që mbanin dy personat e tjerë në paraqitje për njohje ishin të ndryshme nga ato që mbanin veshur kërkuesit (shih paragrafin 2 më lart). Megjithatë, ndryshe nga qëndrimi në çështjen *Laska dhe Lika*, në këtë çështje rrobat e veshura nga kërkuesi nuk kishin rëndësi të madhe sepse P. S., i cili e identifikoi kërkuesin si autor gjatë paraqitjes për njohje, e kishte parë tashmë qartë fytyrën e tij. Prandaj, nuk mund të thuhet se ai e ka njohur kërkuesin nga rrobat që kishte veshur. Gjithashtu, para se të ftohej për të vëzhguar personat në paraqitjen për njohje, P. S. kishte dhënë një përrshkrim të detajuar të autorit.

58. Gjykata vëren gjithashtu se vendimi i apelit nuk përmendi paraqitjen për njohje kur renditi provat mbi të cilat ishte përcaktuar fajësia e kërkuesit. Dëshmitari P. S., i cili e identifikoi kërkuesin gjatë paraqitjes për njohje, dha dëshminë e tij gjatë gjykimit dhe gjykatat e morën parasysh atë dëshmi në vendimet e tyre. Siç u tha më lart, dëshmia e dhëna nga P. S. në gjykim është vërtetuar me provat e marra me masën e përgjimit të fshehtë dhe deklaratimet e dhëna nga D. L. dhe V. K.

59. Nga kjo rezulton se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket mënyrës së kryerjes së paraqitjes për njohje.

2. Ndryshimi i akuzave nga Gjykata e Apelit

a) Parashtrimet e palëve

60. Kërkuesi argumentoi se Gjykata e Apelit kishte ndryshuar akuzat kundër tij dhe se ai nuk kishte pasur mundësi të mbrohej kundër akuzave të ndryshuara, sepse e kishte mësuar për ndryshimin vetëm nga vendimi i Gjykatës së Apelit.

61. Qeveria argumentoi se Gjykata e Apelit kishte ndryshuar akuzat kundër kërkuesit në përputhje me rregullat e procedurës të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale. Në lidhje me këtë, ata pohuan se ishte në kompetencën e gjykatave që të bënin cilësimin ligjor të fakteve të provuara. Ata argumentuan se Gjykata e Apelit nuk e kishte ndryshuar natyrën e akuzës kundër kërkuesit, por kishte dhënë vetëm interpretimin e saj ligjor të fakteve të çështjes, që ishte në të vërtetë roli i një gjykate. Qeveria pretendoi gjithashtu se vetë avokati i kërkuesit i kishte kërkuar Gjykatës së Apelit ndryshimin e akuzave kundër kërkuesit. Qeveria theksoi se cilësimi ligjor i akuzave nga Gjykata e Apelit i treguar nga faktet e çështjes ishte më i favorshëm për kërkuesin se akuzat për të cilat ai ishte dënuar nga gjykata e shkallës së parë, pavarësisht nga fakti se dënimi i tij i përjetshëm ishte lënë në fuqi.

b) Parashtrimet e palës së tretë

62. Pala e tretë, Res Publica, nuk bëri asnjë koment në lidhje me ankesën e kërkuesit për ndryshimet e akuzave kundër tij nga Gjykata e Apelit.

c) Vlerësimi i Gjykatës

i. Parime të përgjithshme

63. Parimet e përgjithshme në lidhje me ricilësimin e një vepre penale për të cilën u akuzua fillimisht kërkuesi janë përmbledhur në çështjen *Pélissier dhe Sassi kundër Francës* ([DHM], nr. 25444/94, § 62, GJEDNJ 1999-II)

64. Gjykata është shprehur, në veçanti, se neni 6 § 3 (a) i Konventës i jep të pandehurit të drejtën për t'u informuar jo vetëm për shkakun e akuzës, domethënë për veprimet që pretendohet se ai ka kryer dhe mbi të cilën bazohet akuza, por edhe për cilësimin ligjor që u është bërë atyre veprimeve. Në çështjet penale, dhënia e informacionit të plotë dhe të detajuar në lidhje me akuzat kundër një të pandehuri, dhe rrjedhimisht cilësimi ligjor që gjykata mund të bëjë në këtë çështje, është një parakusht thelbësor për të siguruar që proceset gjyqësore të jenë të drejta. Për më tepër, Gjykata është shprehur se nën-paragrafët (a) dhe (b), të nenit 6 § 3 janë të lidhura dhe se e drejta për t'u informuar për natyrën dhe shkakun e akuzës duhet të merret parasysh në dritën e të drejtës së të akuzuarit për të përgatitur mbrojtjen e tij ose të saj (shih, midis vendimeve të tjera, *Sipavičius kundër Lituanisë*, nr. 49093/99, § 28, 21 shkurt 2002).

65. Në vlerësimin e drejtësisë së procesit penal në tërësi, Gjykata ka pranuar se ricilësimi i një vepre penale nuk do të cenojë të drejtat e mbrojtjes nëse i akuzuari, në proces rishqyrtimi, do të kishte një mundësi të mjaftueshme për të mbrojtur veten (shih *Mulosmani kundër Shqipërisë*, nr. 29864/03, § 132, 8 tetor 2013, dhe çështjet e cituara aty; shih gjithashtu *Balette kundër Belgjikës* (vend.), nr. 48193/99, 24 qershor 2004).

66. Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 6 në çështjet ku elementët përbërës të veprës penale origjinale për të cilën akuzohej i akuzuari ndryshonin nga ato të veprës penale të ricilësuar dhe i akuzuari nuk kishte mundësi të mbrohej kundër veprës së ricilësuar (shih, për shembull, *Penev kundër Bullgarisë*, nr. 20494/04, §§ 33–45, 7 janar 2010, dhe *D.M.T. dhe D.K.I. kundër Bullgarisë*, nr. 29476/06, §§ 76–84, 24 korrik 2012). Nga ana tjetër, në çështjet ku elementët përbërës të veprës penale origjinale përfshinin të gjithë elementët përbërës të veprës penale të ricilësuar, Gjykata është shprehur se të akuzuarit tashmë i ishte dhënë një mundësi efektive për të mbrojtur veten. Prandaj, informimi i të akuzuarit për akuzat e ricilësuar vetëm pas dorëzimit të një vendimi nuk përbën shkelje të të drejtave të kërkuesit sipas nenit 6 të Konventës (shih, për shembull, *Gea Catalán kundër Spanjës*, 10 shkurt 1995, §§ 28–30, Seria A nr.309; *De Salvador Torres kundër Spanjës*, 24 tetor 1996, §§ 30–33, *Raporte* 1996; dhe *Marilena-Carmen Popa kundër Rumanisë*, nr. 1814/11, §§ 36–49, 18 shkurt 2020).

67. Një ricilësim i veprës penale konsiderohet se është mjaftueshëm i parashikueshëm për të akuzuarin nëse ka të bëjë me një element që është thelbësor për akuzën (shih *De Salvador Torres*, cituar më lart, § 33; *Sadak dhe të tjerët kundër Turqisë* (nr. 1), nr. 29900/96 dhe 3 të tjerë, §§ 52 dhe 56, GJEDNJ 2001-VIII; dhe *Juha Nuutinen kundër Finlandës*, nr. 45830/99, § 32, 24 prill 2007). Nëse elementët e veprës së ricilësuar janë diskutuar në proces kjo është një konsideratë tjetër e rëndësishme (shih *Penev*, cituar më lart, § 41).

ii. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

68. Në procesin në gjykatën e shkallës së parë, kërkuesi u akuzua dhe u dënua për vrasjen e dy ose më shumë personave në rrethana të tjera të cilësuar, sipas nenit 22 dhe nenit 79 (dh) të Kodit Penal, si dhe për armëmbajtje pa leje sipas nenit 278 § 2 të të njëjtit Kod.

69. Në procesin në apel, akuzat u ricilësuan si vjedhje e mbetur në tentativë me pasojë vdekjen e A. S., sipas neneve 141 dhe 22 të Kodit Penal, dhe vrasje e mbetur në tentativë e P. S. me synim kryerjen e një krimi tjetër, sipas neneve 77 dhe 22 të Kodit Penal. Akuza për armëmbajtje pa leje nuk u ndryshua.

70. Gjykata vëren se thelbi i ndryshimit të akuzave kundër kërkuesit nga Gjykata e Apelit ishte se ai kishte nxitur A. S. të shkonte në Shijan me pretekstin se donte të këmbente 8000 euro, edhe pse e

dinte mirë se nuk i kishte ato para dhe se qëllimi i tij i vërtetë ishte t'i merrte A. S.-së shumën përkatëse. Për këtë qëllim, kërkuesi kishte marrë një armë me vete dhe në fund kishte qëlluar dhe vrarë A. S. dhe tentoi të vriste P. S. teksa po largohej nga vendi i krimit.

71. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren më tej se elementët përbërës të veprës penale të vrasjes për të cilën kërkuesi u akuzua dhe u dënua fillimisht në shkallë të parë nuk janë domosdoshmërisht të njëjta sipas ligjit të brendshëm me ato të veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e një personi.

72. Megjithatë, edhe në kërkesën për dërgimin e çështjes së kërkuesit për gjykim, prokurori kishte pretenduar se kërkuesi kishte kontaktuar A. S. në Sarandë ditën e ngjarjes dhe i kishte kërkuar të këmbente 8000 euro me monedhën shqiptare edhe pse nuk e kishte pasur atë shumë parash (shih paragrafin 14 më lart).

73. Për më tepër, faktet në themel të dënimit të kërkuesit nga gjykata e shkallës së parë përfshinin gjetjen se, gjatë takimit të tij të parë me A. S. mëngjesin e datës 23 gusht 2005 në Sarandë, kërkuesi kishte krijuar tashmë synimin për t'i marrë paratë prej tij dhe se me këtë synim kërkuesi i kishte kërkuar A. S. që të këmbente shumën prej 8 000 eurosh me monedhën shqiptare dhe i kishte kërkuar që atë pasdite t'i çonte në Shijan shumën përkatëse të lekëve. (shih paragrafin 21 më lart).

74. Sa më sipër tregon se të gjitha faktet në bazë të akuzës së ndryshuar i ishin bërë me dije kërkuesit që në fillim të gjykimit të tij. Asnjë element i ri faktik nuk u prezantua nga Gjykata e Apelit. Prandaj, nuk mund të thuhet se kërkuesi nuk mund të kishte parashikuar ricilësimin e akuzave kundër tij. Për më tepër, në seancat e mbajtura në Gjykatën e Apelit më 16 mars dhe 5 prill 2006, avokati i kërkuesit i kërkoi gjykatës të ndryshonte akuzat kundër kërkuesit dhe argumentoi se kërkuesi mund të dënohej për çdo vepër, përveç vrasjes. Më pas ai në fjalën e tij përfundimtare kërkoi që akuza të ricilësohej si vrasje me dashje (neni 76 i Kodit Penal).

75. Duke qenë se si kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes për gjykim ashtu edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë përfshinin faktet mbi bazën e të cilave gjykata e apelit ndryshoi më vonë akuzat, përkatësisht synimin e kërkuesit për të vjedhur para nga A. S., Gjykata vlerëson se kërkuesi kishte kohën dhe mundësitë e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij ndaj akuzave kundër tij, duke përfshirë pretendimin se ai kishte për synim të vidhte para nga A. S. të cilit i kishte kërkuar t'i sillte paratë në Shijan.

76. Në fakt, në deklarinimin e tij të dhënë gjatë hetimit, kërkuesi tha se, edhe pse mendonte se i kishte thënë A. S. se do të sillte eurot me vete, në fakt ai nuk kishte para dhe kishte ndërmend t'i merrte lekët nga A. S. pa i dhënë asnjë euro në këmbim. Kërkuesi tha gjithashtu se ai kishte marrë me vete një armë me qëllim që të trembte A. S. dhe t'i merrte paratë. Kur ai kishte marrë A. S. dhe P. S. në një shtëpi të braktisur, kërkuesi kishte nxjerrë armën dhe i kishte kërkuar paratë A. S.-së. (shihni paragrafin 8 më lart).

77. Në gjykim kërkuesi ndryshoi dëshminë e tij, duke pretenduar se A. S. i kishte borxh para dhe se A. S. kishte sjellë armën të cilën kërkuesi ia mori dhe qëlloi në drejtim të A. S. kur kishin filluar të përlesheshin (shih paragrafin 15 më lart).

78. Nga kjo rezulton se kërkuesi kishte një mundësi të përshtatshme, gjatë hetimit dhe në gjykimin para gjykatës së shkallës së parë, për të paraqitur mbrojtjen e tij në lidhje me elementët përbërës të veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e një personi, e cila ishte nuk ishte e paparashikueshme për kërkuesin në asnjë aspekt thelbësor. Ai në fakt në mbrojtjen e tij ka trajtuar rrethanat që kanë të bëjnë me veprën penale të vjedhjes me dhunë. Prandaj, ricilësimi i akuzave nga Gjykata e Apelit nuk e kishte rritur barrën mbi kërkuesin.

79. Duke vlerësuar drejtësinë e procesit në tërësi, Gjykata nuk mund të pranojë argumentin se kërkuesit nuk ishte informuar mjaftueshëm për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij për qëllimet e nenit 6 § 3 (a) të Konventës, ose se garancia sipas nenit 6 § 3 (b) të Konventës nuk u respektua, ose se atij nuk i ishte mundësuar një seancë dëgjimore e drejtë sipas kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës.

80. Prandaj në këto rrethana konstatohet se nuk ka shkelje të nenit 6 6 § 1 dhe 3 (a) dhe (b) të Konventës.

3. E drejta e kërkuarit për ndihmë juridike falas

a) Parashtrimet e palëve

81. Kërkuari argumentoi se ai ishte marrë në pyetje nga prokuroria në mungesë të një avokati. Autoritetet e kishin pranuar se ai nuk kishte mjete për të paguar ndihmën juridike, dhe për këtë arsye atij i ishte ofruar ndihmë juridike falas, por vetëm pasi hetimi kishte përfunduar tashmë. Ai u shpreh se ishte e qartë që nga fillimi i hetimit se ai nuk kishte mjete për të përballuar ndihmën juridike dhe se ndihma juridike falas duhej t'i ishte ofruar dhe dhënë që nga marrja e parë e tij në pyetje si i dyshuar.

82. Qeveria pretendoi se kërkuari ishte informuar për të drejtat e tij për të heshtur dhe për t'u përfaqësuar nga një avokat, por ai kishte vendosur të deklaronte pa ndihmën e një avokati. Në këndvështrimin e Qeverisë, kërkuari kishte hequr dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike në fazën e hetimit. Qeveria parashtrroi gjithashtu se gjatë gjykimit kërkuarit i ishte ofruar ndihmë juridike falas.

b) Parashtrimet e palës së tretë

83. Pala e tretë, Res Publica, theksoi rëndësinë e së drejtës së një të akuzuarit për të pasur një avokat dhe vuri në dukje se kjo e drejtë garantohej me instrumente të ndryshme ndërkombëtare. Ajo iu referua *Konkluzione përmbyllëse mbi raportin e dytë periodik të Shqipërisë* të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të 22 gushtit 2013, ku autoritetet shqiptare u ishte kërkuar të siguronin që personat e ndaluar të kishin të drejtën për avokat menjëherë pas arrestimit. Një koment i ngjashëm ishte bërë nga Komiteti Kundër Torturës i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në vitin 2012 dhe nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtërues në vitin 2010.

84. Res Publica kritikoi më tej garancitë e të drejtave të të akuzuarve sipas Kodit të Procedurës Penale shqiptare.

85. Ata u mbështetën në një sërë vendimesh të Gjykatës që trajtonin çështjen e së drejtës së një kërkuari për t'u përfaqësuar nga një avokat (veçanërisht, *Laska dhe Lika*, cituar më lart; *Kaçin dhe Kotorri kundër Shqipërisë*, nr. 33192/07 dhe 33194/07, 25 qershor 2013; *Dvorski kundër Kroacisë* [DHM], nr. 25703/11, GJEDNJ 2015; dhe *Simeonovi kundër Bullgarisë* [DHM], nr. 21980/04, 12 maj 2017).

c) Vlerësimi i Gjykatës

i. Parime të përgjithshme në lidhje me të drejtën për avokat

86. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për avokat mund të gjenden në vendimet e Dhomës së Madhe në çështjen *Beuze kundër Belgjikës* ([DHM], nr. 71409/10, §§ 119-50, 9 nëntor 2018); *Simeonovi*, cituar më lart, §§ 110-20; *Ibrahimi dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* ([DHM], nr. 50541/08 dhe 3 të tjerë, §§ 249-74, 13 shtator 2016); dhe *Dvorski*, cituar më lart, §§ 76-82).

87. Në veçanti, Gjykata është shprehur se e drejta e secilit “të akuzuar për një vepër penale” për t'u mbrojtur efektivisht nga një avokat, e garantuar nga neni 6 § 3 (c), është një nga tiparet themelore të një gjykimi të drejtë (shih *Salduz kundër Turqisë* [DHM], no. 36391/02, § 51, GJEDNJ 2008; *Ibrahim dhe të tjerë*, § 255; dhe *Beuze*, § 123, të dyja cituar më lart).

88. Kur një person është arrestuar, momenti fillestar për të drejtën për avokat nuk vihet në dyshim. E drejta bëhet e zbatueshme sapo ka një “akuzë penale” në kuptimin që i jep këtij koncepti praktika gjyqësore e Gjykatës dhe, në veçanti, nga momenti i arrestimit të të dyshuarit, pavarësisht nëse ai person pyetet apo merr pjesë në ndonjë masë tjetër hetimore gjatë periudhës përkatëse (shih *Simeonovi*, §§ 110-11, dhe *Beuze*, § 124, të dyja të cituara më lart).

89. Për sa u përket qëllimeve të ndjekura nga e drejta për një avokat, Gjykata u shpreh në çështjen *Beuze* (cituar më lart, §§ 125-30) si më poshtë:

“125. E drejta për avokat në fazën paraprake të procedimit kontribuon gjithashtu në parandalimin e gabimeve të drejtësisë dhe, mbi të gjitha, në përmbushjen e qëllimeve të nenit 6, veçanërisht barazinë e armëve ndërmjet autoriteteve

hetimore ose të ndjekjes penale dhe të akuzuarit. (shih *Salduz*, cituar më lart, §§ 53–54; *Blokhin*, cituar më lart, § 198; *Ibrahim dhe të tjerët*, cituar më lart, § 255; dhe *Simeonovi*, cituar më lart, § 112).

126. Gjykata ka pranuar në shumë raste që nga vendimi i *Salduz* se mundësi i shpejtë i një avokati përbën një kundërpeshë të rëndësishme ndaj cenueshmërisë së të dyshuarve në ndalim policor. Kjo e drejtë është gjithashtu parandaluese, pasi ofron një garanci themelore kundër shtrëngimit dhe keqtrajtimin të të dyshuarve nga policia (shih *Salduz*, cituar më lart, § 54; *Ibrahim dhe të tjerët*, cituar më lart, § 255; dhe *Simeonovi*, cituar më lart, § 112).

127. Gjykata ka pranuar gjithashtu se cenueshmëria e të dyshuarve mund të përforcohet nga legjislacioni gjithnjë e më kompleks për procedurën penale, veçanërisht në lidhje me rregullat që rregullojnë mbledhjen dhe përdorimin e provave (shih *Salduz*, cituar më lart, § 54, dhe *Ibrahim dhe të tjerët*, cituar më lart, § 253).

128. Në fund, një nga detyrat kryesore të avokatit në fazat e ndalimit në polici dhe hetimit është të sigurojë respektimin e të drejtës së një të akuzuari për të mos inkriminuar veten (shih *Salduz*, cituar më lart, § 54; *Dvorski*, cituar më lart, § 77; dhe *Blokhin*, cituar më lart, § 198) dhe për të drejtën e tij për të heshtur.

129. Në lidhje me këtë, Gjykata e ka konsideruar si të natyrshme në të drejtën kundër vetë-inkriminimit, të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për ndihmë juridike, që një person ‘i akuzuar për një vepër penale’, sipas kuptimit të nenit 6, duhet të ketë të drejtë të informohen për këto të drejta, pa të cilat mbrojtja e garantuar në këtë mënyrë nuk do të ishte praktike dhe efektive (shih *Ibrahim dhe të tjerët*, cituar më lart, § 272, dhe *Simeonovi*, cituar më lart, § 119; plotësimi i këtyre të drejtave ishte theksuar tashmë në *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 8 shkurt 1996, § 66, *Raportet e vendimeve* 1996-I; *Brusco kundër Francës*, nr.1466/07, § 54, 14 tetor 2010; dhe *Navone dhe të tjerët*, cituar më lart, §§ 73-74). Rrjedhimisht, neni 6 § 3 (c) i Konventës duhet të interpretohet si mbrojtje e të drejtës së personave të akuzuar për një vepër penale për t’u informuar menjëherë për përmbajtjen e së drejtës për ndihmë juridike, pavarësisht nga mosha ose situata e tyre specifike dhe pavarësisht nëse ata përfaqësohen nga një avokat i caktuar kryesisht ose një avokat i zgjedhur prej tyre (shih *Simeonovi*, cituar më lart, § 119).

130. Nisur nga natyra e së drejtës kundër vetë-inkriminimit dhe të drejtës për të heshtur, Gjykata vlerëson se në parim nuk mund të ketë asnjë justifikim për mosnjofitim të të dyshuarit për këto të drejta. Megjithatë, kur një i dyshuar nuk është njoftuar, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse, pavarësisht këtij mosnjoftimi, procedurat në tërësi kanë qenë të drejta. Mundësi i menjëhershëm i avokatit që të japë informacion në lidhje me të drejtat procedurale ka mundësi të pengojë padrejtësinë që rrjedh nga mungesa e një njoftimi zyrtar për këto të drejta. Megjithatë, kur ka vonesa në mundësimin e një avokati, nevoja që autoritetet hetimore të njoftojnë të dyshuarin për të drejtën e tij për një avokat, të drejtën e tij për të heshtur dhe të drejtën për të mos inkriminuar veten merr një rëndësi të veçantë (shih *Ibrahim dhe të tjerët*, cituar më lart, § 273, dhe praktika gjyqësore e cituar aty).’.

ii. Parime të përgjithshme në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike falas

90. Gjykata rithekson se e drejta e të akuzuarit për ndihmë juridike falas, e parashikuar në nenin 6 § 3 (c) të Konventës, është një nga elementët thelbësorë në nocionin e gjykimit të drejtë. Kjo dispozitë i cakton dy kushte kësaj të drejte. I pari është mungesa e “mjeteve të mjaftueshme për të paguar për ndihmën juridike”, i dyti është që “interesat e drejtësisë” duhet të kërkojnë që kjo ndihmë të jepet falas (shih *Pham Hoang kundër Francës*, 25 shtator 1992, § 39, Seria A nr. 243; *R. D. kundër Polonisë*, nr. 29692/96 dhe 34612/97, § 43, 18 dhjetor 2001; dhe *Zdravko Stanev kundër Bullgarisë*, nr. 32238/04, § 36, 6 Nëntor 2012).

91. Për sa i përket kushtit të parë, Gjykata e ka konsideruar të pranueshme që barra e provës për mungesë të mjeteve të mjaftueshme duhet të bartet nga personi që e kërkon atë (shih *Caresana kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 31541/96, 29 gusht 2000). Gjykata nuk mund të zëvendësojë veten me gjykatat kombëtare në kryerjen e këtij vlerësimi; në vend të kësaj duhet të shqyrtojë nëse ato e kanë vlerësuar çështjen në përputhje me kërkesat e nenit 6 (shih *R. D. kundër Polonisë*, cituar më lart, § 45, dhe *Tsonyo Tsonev kundër Bullgarisë* (nr. 3), nr. 21124/04, § 51, 16 tetor 2012).

92. Për sa i përket kushtit nëse interesat e drejtësisë kërkonin që kërkuesi të merrte ndihmë juridike falas në formën e një avokati të caktuar nga gjykata, Gjykata mban parasysh rëndësinë e masës që mund të marrë kërkuesi, kompleksitetin e çështjes dhe situatën personale të kërkuesit (shih *Quaranta kundër Zvicrës*, 24 maj 1991, § 33, Seria A nr. 205). Gjykata ka vendosur se aty ku rrezikohet heqja e lirisë, interesat e drejtësisë në parim kërkojnë përfaqësim ligjor dhe nëse i pandehuri nuk mund ta paguajë vetë, fondet publike duhet të jenë të disponueshme sipas nevojës (shih *Zdravko Stanev*, cituar më lart, § 38).

iii. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

93. Gjykata vlerëson se, pasi u arrestua me dyshimin për një vepër penale dhe u pyet nga prokuroria, kërkuesi u bë objekt i një “akuze penale” sipas kuptimit të praktikës së saj gjyqësore (shih *Ibrahim dhe të tjerët*, § 249; *Simeonovi*, § § 110-11 dhe 121; dhe *Beuzë*, § 124, të gjitha të cituara më lart). Kështu, garancitë e përcaktuara në nenet 6 §§ 1 dhe 3 (c) të interpretuara nga Gjykata nënkuptonin që kërkuesi kishte të drejtë të ndihmohej nga një avokat gjatë marrjes në pyetje, përveç rasteve kur kishte arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë dhe sipas një vlerësimi të drejtësisë së përgjithshme të proceseve gjyqësore.

α) Nëse kërkuesi kishte të drejtë për ndihmë juridike falas

94. Gjykata përsërit në këtë pikë se e drejta për ndihmë juridike falas i nënshtrohet dy kushteve, përkatësisht që i akuzuari të mos ketë mjete për të përballuar ndihmën juridike të zgjedhur prej tij dhe që interesat e drejtësisë të kërkojnë që atij ose asaj t'i sigurohet ndihmë juridike falas (shih paragrafët 94 dhe 95 më lart).

95. Për sa i përket kushtit të parë, Gjykata vëren se në përfundim të hetimit, kërkuesit iu ofrua ndihmë juridike falas me arsyetimin se ai nuk kishte mjete për të përballuar një avokat të zgjedhur prej tij. Qeveria nuk ka dhënë sqarime se pse ky vlerësim nuk është kryer që në fazat e hershme të hetimit.

96. Për sa i përket kushtit të dytë, Gjykata vëren se nuk ka asnjë tregues se autoritetet vlerësuan nëse interesat e drejtësisë kërkonin që kërkuesit t'i jepej ndihmë juridike falas që nga fillimi i marrjes në pyetje si i dyshuar. Në lidhje me këtë, është e qartë se kërkuesi u hetua dhe më pas u akuzua për vepra shumë të rënda, dhe mund të dënohej me burgim të përjeshëm. Duke pasur parasysh rëndesën e situatës së kërkuesit, Gjykata nuk ka dyshim se interesat e drejtësisë kërkonin që atij t'i jepej ndihmë juridike falas që në fillim.

97. Për sa u përket pasojave të kufizimeve mbi të drejtën për ndihmë juridike falas, qasja aktuale e Gjykatës, siç konfirmohet në disa çështje të Dhomës së Madhe, kërkon që kjo çështje të vlerësohet si një element i drejtësisë së procesit në tërësi (shih *Hamdani kundër Zvicrës*, nr.10644/17, § 29, 28 mars 2023, duke cituar *Jemeljanovs kundër Letonisë*, nr. 37364/05, §§ 77 dhe 78, 6 tetor 2016; *Beuzë*, cituar më lart, §§ 120–123; dhe *Murtaçalijeva kundër Rusisë* [DHM], nr. 36658/05, § 90, 18 dhjetor 2018).

β) Nëse kërkuesi hoqi dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike gjatë marrjes në pyetje gjatë hetimit

98. Gjykata është shprehur se as shkronja dhe as fryma e nenit 6 të Konventës nuk e pengojnë një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë, të shprehur ose jo, nga e drejta për garancitë e një gjykimi të drejtë. Megjithatë, kjo heqje dore, nëse do të jetë efektive për qëllimet e Konventës, duhet të provohet në mënyrë të qartë; nuk duhet të jetë në kundërshtim me ndonjë interes të rëndësishëm publik dhe duhet të shoqërohet me garanci minimale në raport me rëndësinë e saj. Kjo heqje dore nuk ka pse të jetë e shprehur, por duhet të jetë me dëshirë dhe të përbëjë heqje dore me dijeni të plotë dhe të kuptueshme. Përpara se të thuhet që një i akuzuar në mënyrë të nënkuptuar, nëpërmjet sjelljes së tij, ka hequr dorë nga një e drejtë e rëndësishme sipas nenit 6, duhet të tregohet se ai mund të kishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme se cilat do të ishin pasojat e sjelljes së tij (shih *Simeonovi*, cituar më sipër, § 115). Nga kjo rrjedh se heqja dorë nga e drejta për avokat, një e drejtë themelore mes atyre të përmendura në nenin 6 § 3 që përbëjnë nocionin e një gjykimi të drejtë, duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e mësipërme (shih, *mutatis mutandis*, *Murtaçalijeva*, cituar më lart, § 118).

99. Në lidhje me këtë, mund të theksohet se e drejta për avokat është një shembull kryesor i atyre të drejtave që kërkojnë mbrojtjen e veçantë të standardit të “heqjes dorë me dijeni të plotë dhe në mënyrë të kuptueshme” të vendosur në praktikën gjyqësore të Gjykatës (shih *Dvorski*, cituar më lart, § 100 dhe çështjet e cituara aty).

100. Për sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesi u mor në pyetje nga prokuroria në tre raste, më 27 gusht dhe më 14 dhe 22 shtator 2005. Procesverbalet e atyre intervistave tregojnë se kërkuesi u informua për të drejtën e tij për të heshtur dhe për t'u ndihmuar nga një avokat dhe tha se

ai do të jepte deklarinimin e tij pa një avokat dhe do të vendoste më vonë nëse do të kishte një avokat. Kërkuesi i nënshkroi ato procesverbale pa bërë asnjë koment. Kërkuesi nuk e kundërshtoi vlefshmërinë e nënshkrimeve (krahaso *Rusishvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 15269/13, § 41, 30 qershor 2022).

101. Megjithatë, Gjykata vëren se kërkuesi u informua për të drejtën e tij për avokat disi në mënyrë të përmbledhur dhe nuk u bë e qartë nëse kjo i referohej një avokati të zgjedhur prej tij apo një avokati të ofruar nga autoritetet pa pagesë, në varësi të kushteve të caktuara. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se detyrimi i autoriteteve sipas ligjit të brendshëm për t'u dhënë të pandehurve një “letër të të drejtave” që përmban informacion në lidhje me të drejtat e tyre, duke përfshirë të drejtën e tyre për të heshtur dhe për të pasur një avokat të zgjedhur prej tyre ose ndihmë juridike falas sipas kushteve të caktuara, nuk ishte në fuqi deri më 1 gusht 2017 (shih paragrafin 32 më lart). Prandaj, kërkuesit nuk iu dha një “letër e të drejtave” përpara marrjes së tij në pyetje për herë të parë.

102. Një situatë ku kërkuesit nuk i jepet “letër e të drejtave” dhe ku procesverbalet e marrjes në pyetje të kërkuesit, megjithëse i referoheshin nenit 309 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ishin të qarta nëse atij i ishte shpjeguar e drejta për ndihmë juridike falas, nga këndvështrimi i Gjykatës nuk mund të shihet si e tillë që përmbush standardit e “dijenisë dhe kuptueshmërisë” të vendosur në jurisprudencën e Gjykatës që heqja dorë të jetë e vlefshme (shih paragrafin 46 më lart). Në radhë të parë i takon autoriteteve kombëtare të përcaktojnë në mënyrë bindëse se heqja dorë nga ndihma juridike ka qenë me vullnet të lirë (shih *Türk kundër Turqisë*, nr. 22744/07, § 53, 5 shtator 2017, dhe *Agdağ kundër Turqisë*, nr.75460/10, § 61, 17 shtator 2019). Prandaj, Gjykata vlerëson se Qeveria nuk ka arritur të tregojë se kërkuesi ka hequr dorë në mënyrë të vlefshme nga e drejta e tij për avokat, dhe në veçanti për ndihmë juridike falas, kur ka dhënë deklarinimet në prokurori.

103. Prandaj, nuk mund të thuhet se duke nënshkruar procesverbalet e marrjes në pyetje dhe duke thënë se do të jepte deklarinimin e tij pa avokat, kur nuk ishte vënë në dijeni shprehimisht për të drejtën e tij për ndihmë juridike falas, kërkuesi ka hequr dorë qartazi nga e drejta e tij për ndihmë juridike, në heshtje ose në mënyrë shprehur.

104. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se e drejta e kërkuesit për ndihmë juridike ishte e kufizuar.

γ) Nëse kishte “arsye bindëse” për të kufizuar të drejtën për avokat

105. Gjykata rithekson se kufizimet në të drejtën për avokat për arsye bindëse në fazën e hetimit lejohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, duhet të jenë me natyrë të përkohshme dhe duhet të bazohen në një vlerësim individual të rrethanave të veçanta të çështjes (shih *Simeonovi*, cituar më lart, § 130).

106. Qeveria nuk ka arritur të tregojë ekzistencën e ndonjë rrethane të jashtëzakonshme që mund të justifikonte kufizimet në të drejtën e kërkuesit. Si rezultat, kufizimet në fjalë nuk u justifikuan me ndonjë arsye bindëse.

δ) Drejtësia e procesit në tërësi

107. Gjykatës i kërkohet të shqyrtojë, nisur nga një sërë faktorësh jo shterues të përcaktuar në praktikën e saj gjyqësore (shih *Ibrahim dhe të tjerët*, cituar më lart, § 274), nëse kufizimet në të drejtën e kërkuesit për një avokat ishin të tilla që të cenonin drejtësinë e përgjithshme të procesit penal kundër tij nga këndvështrimi i nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës, duke ushtruar një kontroll shumë të rreptë në mungesë të arsyeve bindëse për atë kufizim (shih çështjet e lart- përmendura *Beuze*, § 145; *Ibrahim dhe të tjerët*, § 265; dhe *Simeonovi*, §§ 118 dhe 132; shih gjithashtu *Koben dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 66616/10 dhe 3 të tjerë, § 57, 7 qershor 2022).

- Nëse kërkuesi ishte i cenneshëm

108. Gjykata vëren se në kohën e ngjarjeve në fjalë dhe të marrjes në pyetje nga prokuroria, kërkuesi ishte 22 vjeç dhe ishte i punësuar si murator. Nuk ka asnjë tregues në dosjen e çështjes që kërkuesi vuante nga ndonjë dëmtim specifik, dhe as kërkuesi nuk ka bërë ndonjë pretendim në këtë drejtim.

Nga materiali i dosjes, nuk mund të thuhet se gjatë deklarimeve në prokurori, kërkuesi ishte në gjendje kaq të keqe sa duhej të konsiderohej i papërshtatshëm ose jo i gatshëm për të bashkëpunuar. Prandaj, nuk mund të thuhet se kërkuesi nuk ishte në gjendje të kuptonte situatën në të cilën ndodhej. Gjykata nuk mund të dallojë rrethana të tjera të veçanta që tregojnë se kërkuesi ishte në një gjendje më të madhe cenueshmërie se ajo në të cilën do të gjendeshin përgjithësisht personat e pyetur nga autoritetet hetimore.

- *Rrethanat në të cilat janë marrë provat*

109. Gjykata rithekson se kur ka vonesa në mundësimin e një avokati, nevoja që autoritetet hetimore të njoftojnë të dyshuarin për të drejtën e tij për një avokat, të drejtën e tij për të heshtur dhe të drejtën për të mos inkriminuar veten merr një rëndësi të veçantë (shih *Ibrahim dhe të tjerët*, cituar më lart, § 273, dhe praktika gjyqësore e cituar aty). Vlen të përmendet se, në çështjen në fjalë, kërkuesi u informua në mënyrë të përsëritur, përpara çdo marrjeje në pyetje, për të drejtën e tij për të heshtur dhe për të drejtën e tij për ndihmë juridike (krahaso *Farrugia kundër Maltës*, nr. 63041/13, § 112, 4 qershor 2019, dhe bëni dallimin me *Beuze*, i cituar më lart, § 184; shih gjithashtu paragrafët 8 dhe 12 më lart). Pavarësisht nga fakti që Gjykata ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike gjatë marrjes në pyetje nga prokuroria në rrethanat e çështjes, megjithatë rezultojnë se kërkuesi mund të kishte zgjedhur të heshtte (krahaso *Farrugia*, cituar më sipër, § 112).

110. Për më tepër, nuk ka asnjë sugjerim që kërkuesi i ishte nënshtruar keqtrajtimit nga policia ose prokuroria gjatë pyetjes ose paraqitjes për njohje (krahaso *Doyle kundër Irlandës*, nr. 51979/17, § 86, 23 maj 2019, dhe *Farrugia*, cituar më sipër, § 111). Për sa i përket pretendimit të kërkuesit, të paraqitur për herë të parë nga avokati i tij në një seancë përpara Gjykatës së Apelit, se ai ishte i detyruar të nënshkruante procesverbalet e marrjes në pyetje nga prokuroria, Gjykata vëren se kërkuesi nuk e ngriti këtë çështje aspak gjatë gjykimit të tij në gjykatën e shkallës së parë (krahaso *Kuralić kundër Kroacisë*, nr. 50700/07, §§ 41, 46 dhe 49, 15 tetor 2009), dhe se nuk ka asnjë të dhënë në dosjen e çështjes për ndonjë detyrim të tillë.

- *Nëse kërkuesi ishte në gjendje të kundërshtonte provat dhe të kundërshtonte përdorimin e tyre, natyrën e deklarimit dhe nëse ai u tërhoq ose u ndryshua menjëherë*

111. Në fillim kërkuesi rrëfeu gjatë marrjes në pyetje nga prokuroria më 27 gusht 2005. Ai përsëriti rrëfimin e tij dhe dha më shumë informacion gjatë marrjes në pyetje të mëtejshme nga prokuroria më 14 dhe 22 shtator 2005. Gjatë gjykimit të tij ai mundi të dhe e kundërshtoi përdorimin e deklarimeve që kishte bërë gjatë marrjes në pyetje para gjykimit me arsyetimin se ato ishin marrë në kundërshtim me atë që ai argumentoi se ishte e drejta e tij sipas Konventës për të pasur një përfaqësues ligjor të pranishëm gjatë marrjes në pyetje. Ai pretendoi se në fakt ishte A. S. ai që i kishte para borxh dhe që kishte sjellë një armë në takimin e tyre, dhe se vetëm pasi A. S. e kishte kërcënuar me armë, ai i kishte kapur dorën A. S-së dhe e kishte qëlluar aksidentalisht.

112. Gjykata vlerëson se u takonte gjykatave kombëtare të vlerësonin vlerën provuese të deklarimit të kërkuesit në gjyq. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se gjykata e faktit trajtoi linjën e re të mbrojtjes së kërkuesit, e vlerësoi atë në dritën e provave të tjera dhe arriti në përfundimin se ajo duhej të refuzohej (shih paragrafin 20 më lart).

- *Mënyra si u përdorën provat, dhe në veçanti nëse provat përbënin një pjesë të pandarë ose domethënëse të fakteve provuese mbi të cilat bazohet dënimi, dhe fuqia e provave të tjera në këtë çështje*

113. Për sa i përket fuqisë së provave të tjera, Gjykata së pari rithekson se nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt duke vënë në pikëpyetje rezultatin e një gjykimi ose duke u angazhuar në një vlerësim të fakteve dhe provave ose nëse provat ishin të mjaftueshme për të justifikuar një dënim. Këto çështje, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, janë domeni i gjykatave të brendshme (shih *Koben dhe të tjerë kundër Turqisë*, nr. 66616/10 dhe 3 të tjerë, § 59, 7 qershor 2022). Megjithatë, siç ka gjetur më parë Gjykata, “fuqia e provave të tjera në çështje” është një faktor që duhet marrë parasysh

në vlerësimin e ndikimit të të metave procedurale në fazën hetimore mbi drejtësinë e përgjithshme të procesit penal (shih *Ibrahim dhe të tjerët*, cituar më lart, § 274). Në lidhje me këtë, dhe në rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata vëren si më poshtë.

114. Gjykata vëren se hetimi penal në lidhje me kërkuesin nuk filloi me ose si rezultat i deklarimeve që ai kishte bërë pa pasur ndihmë juridike (krahasoni *Kohen dhe të tjerët*, cituar më lart, § 60). Përpara se kërkuesi të bënte deklaratimet e tij, policia ishte informuar për ngjarjet në fjalë nga P. S., një dëshmitar okular dhe një nga viktimat. Policia fillimisht krijoi dyshime për kërkuesin sepse kishte gjetur numrin e tij të telefonit të personi A. S. Gjithashtu, policia kishte siguruar në mënyrë të ligjshme një regjistrim të fshehtë të bisedës ndërmjet kërkuesit dhe vëllait të tij N. L. ku kërkuesi kishte pranuar krimin në fjalë.

115. Gjykata gjithashtu e vlerëson të rëndësishme që Gjykata e Apelit nuk u mbështet në rrëfimin e kërkuesit kur vlerësoi fajësinë e tij. Ajo u mbështet në prova të tjera thelbësore që tregonin fajësinë e kërkuesit. Në veçanti, ajo kishte parasysh deklaratimet e dhëna nga P. S., D. L. (vëllai i kërkuesit) dhe V. K., si dhe deklaratimin e marrë me masën e përgjimit të fshehtë. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkuesi nuk e kundërshtoi mënyrën se si u mor ajo provë, dhe as vërtetësinë e saj.

116. Gjykata ka parasysh veçanërisht që P. S. ishte dëshmitar okular i ngjarjeve në fjalë nga fillimi deri në fund dhe se gjatë gjithë procesit ai dha dëshminë e tij në mënyrë të qartë dhe të pandryshueshme.

- *Pesha e interesit publik në hetimin dhe dënimin e veprës së caktuar në fjalë*

117. Gjykata vlerëson se natyra e krimeve për të cilat u akuzua kërkuesi, përkatësisht vjedhja me paramendim me pasojë vdekjen e një personi dhe tentativa për vrasjen e një personi tjetër me armë zjarri, nënkuptonte se kishte një interes publik shumë të fortë në ndjekjen penale (krahaso *Doyle*, cituar më lart, § 96).

iv. Konkluzioni në lidhje me drejtësinë e përgjithshme të procesit

118. Nisur nga vlerësimi i mësipërm, Gjykata vlerëson se të gjitha kriteret e treguara në çështjen *Ibrahim dhe të tjerët* (cituar më lart), për aq sa janë të rëndësishme për çështjen në fjalë, të tilla si fuqia e provave të tjera, mungesa e cenueshmërisë së kërkuesit, mundësia për të kundërshtuar autenticitetin e provave, cilësia e provave, vlerësimi i fajësisë nga gjyqtarët profesionistë dhe pesha e interesit publik, ndikojnë në favor të gjetjes se proceset në përgjithësi ishin të drejta.

119. Megjithëse duke pasur parasysh faktin se një kontroll shumë i rreptë duhet të zbatohet për çështjet kur nuk ka arsye bindëse për të kufizuar të drejtën e një kërkuesi për avokat gjatë një hetimi paraprak, Gjykata konsideron se, në rrethanat specifike të çështjes, mungesa i një avokati mbrojtës gjatë marrjes në pyetje të kërkuesit nga prokuroria nuk ishte e tillë që të cenonte në mënyrë të pakthyeshme drejtësinë e përgjithshme të procesit penal kundër tij (krahasoni *Kohen dhe të tjerët*, cituar më lart, § 63; *Doyle*, cituar më lart, § 102; dhe *Pervane kundër Turqisë*, nr. 74553/11, § 32, 8 shtator 2020).

120. Në këto rrethana nuk ka shkelje të nenit 6 § § 1 dhe 3 (c) të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, ME UNANIMITET,

1. shpall kërkesën të pranueshme;

2. vendos se nuk ka shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a), (b) dhe (c) të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 5 mars 2024 sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
KANCELAR

Pere Pastor Vilanova
PRESIDENT

